

VENDIM
Nr. 487, datë 19.7.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 380, DATË 25.5.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË BARNAVE QË RIMBURSOHEN NGA FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE TË MASËS SË MBULIMIT TË ÇMIMIT TË TYRE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 37 të ligjit nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, dhe të pikave 2, shkronja “b”, e 6, të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën nr. 2, që i bashkëlidhet vendimit nr. 380, datë 25.5.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në kategorinë N sistemi nervor, N4 antiparkinsonikët, bari me kodin 262/41 ndryshohet si më poshtë vijon:

Kod bari	Kodi ATC	Principi aktiv	Forma	Emri tregtar	Firma	Çmimi referencë	Çmimi pacienti	Çmimi rimbursimi
262/41	N04BA02	Levodopa 200 mg + Benserazide 50 mg	tabletë	Madopar	ROCHE	27.1	2.7	24.4

2. Efektet financiare të përballohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për vitin 2017.

3. Ngarkohen Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Agjencia e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

